



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0366

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani si paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE “Rinesa” SH.P.K, kundër Njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe restaurimi kullës në Gjonaj (komuna dhe Qrtk)” me numër të prokurimit 622-24-3341-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit, më 21/06/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE “Rinesa” SH.P.K e datës 26.04.2024, me nr. 2024/0366, AK- Komuna e Prizrenit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe restaurimi kullës në Gjonaj (komuna dhe Qrtk)” me numër të prokurimit 622-24-3341-5-2-1.
2. Anulohet Njoftimit për Kontratë i datës 04.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1 të dispozitivit, kurse AK obligohet të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas arsyetimit.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Rinesa” SH.P.K. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 04.04.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi dhe restaurimi kullës në Gjonaj (komuna dhe Qrtk)” me numër të prokurimit 622-24-3341-5-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 150,000.00 Euro (vlerë e mesme).

Me 17.04.2024, OE ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 18.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me 26.04.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0366 (Nr. protokolli).

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Rinesa” SH.P.K ne ankesën Nr. 366/24 janë parashtruar si në vijim:

Në ankesë Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka deklaruar: “Ne si kompani, pas vështirimit të kriterëve të vendosura në këtë dosje të tenderit, kemi vërejtur është shkelur Neni 7 - me këtë rast, mendojmë se AK ka bërë favorizim të ndonjë operatorit ekonomik pjesëmarrës i mundshëm në garë dhe e ka kufizuar mundësinë e pjesëmarrjes. Duke parë te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, te Kërkesa 7. Te pika2. Kamion me kran pesha ngarkesës 5-6 Ton=1 cope dhe pika 4. Kamion kiper me vinç, pesha ngarkesës 7.5- 8.0 Ton= 1 cope, sipas kriterëve të kërkuar ne dosjen e tenderit te 2 pikat, kufizimi në caktimin e kapaciteteve është shumë i ngushtë dhe krijon përshtypjen se AK është duke bërë kufizim të konkurrencës dhe ky është diskriminim dhe favorizim për ndonjë Operator Ekonomik që mund të posedojë këto Pajisje, në të 2 pajisjet shihe te dhe diferenca e peshës së ngarkesës tek Kamioni me kran pesha ngarkesës 5-6 Ton ku diferenca është vetëm IT dhe tek pajisja tjetër Kamion kiper me vinç, pesha ngarkesës 7.5- 8.0 ku diferenca është veç 500kg (0.5T). Ne si OE kërkojmë për të 2 pajisjet të jetë në minimum ose maksimumi i peshës së ngarkesës. Meqë, AK nuk ka marrë parasysh kërkesën për rishqyrtim, kërkojmë nga OSHP që të ndërhyjë dhe të marrë vendimin meritore, ku: 1. Kamion me kran - pesha e ngarkesës 5-6 ton të jetë së paku hapësirë dy ton, meqë kjo diferencë nuk e ndryshon dimensionin e pajisjes në fjalë, pra të jetë 4 deri 6 ton ose 5 deri 7 ton. 2. Kamion kiper me vinç, pesha e ngarkesës 7.5-8 ton, të jetë së paku 2 ton edhe kjo diferencë, meqë as kjo diferencë nuk e ndryshon dimensionin e pajisjes në tërësi për hapësirat e pretenduara nga AK”.

Përgjigje e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE “Rinesa” SH.P.K

Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit në përgjigjen e dhënë në kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues ka refuzuar kërkesën duke deklaruar: “Kërkesa juaj për rishqyrtim konsiderohet e pabazuar pasi që ne si autoritet kontraktues konsiderojmë që nuk kemi përpiluar kriteret as diskriminuese e as favorizuese ndaj operatoreve ekonomik, gjatë përpilimit të kriterëve rreth pajisjeve, janë kërkuar pajisje në pajtueshmëri me kushtet e terrenit, duke pasur

parasysh hapësirën dhe gjendjen e objektit dhe punimeve që do të ekzekutohen në objekt. Nëse si AK-se për pajisjen e kërkuar kamion me kran me peshe ngarkesës 5 deri 6 Ton dhe për pajisjen e kërkuar kamion kiper me vinç me peshe ngarkesës 7.5 deri 8 Ton kemi lejuar minimumin dhe maksimumin e peshës së ngarkesës të pajisjeve, që nënkupton që OE-te konkurrues kanë hapësirë të konsiderueshme të përzgjedhjes rreth peshës së ngarkesës për pajisjet e kërkuara. Si AK-se duke lejuar – përcaktuar limitin-hapësirë të konsiderueshëm për peshë të ngarkesës e paisjeve për minimum dhe si për maksimum për të dy pajisje andaj nuk janë kritere diskriminuese apo favorizuese ndaj një OE konkurrues”.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.04.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 366/2024, ndërsa me datë 14.05.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues dhe eksperti teknik me nr. 2024/366 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.”

Lidhur me pretendimet e OE “Rinesa” SH.P.K” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/366 ka vlerësuar si në vijim:

Operatori Ekonomik ka shfrytëzuar të drejtën për Kërkesë të Rishqyrtimit lidhur me Aktivitetin e Prokurimit: “Ndërtimi dhe restaurimi i kullës në Gjonaj (komuna dhe Qrtk)” me numër 622-24-3341-5-2-1 në Autoritetin Kontraktues Komuna e Prizrenit, me datë 17.04.2024 ku ka paraqitur kërkesën e ngjashme për largimin e kufizimit për Kamion Kiper dhe Kamion Kiper me Vinç, ku me datë 18.04.2024 AK Kuvendi Komunal i Prizrenit, ka paraqitur Vendimin për refuzimin e kërkesës nën arsyetimin: “Nëse si AK-se për pajisjen e kërkuar kamion me kran me peshe ngarkesës 5 deri 6 Ton dhe për pajisjen e kërkuar kamion kiper me vinç me peshe ngarkesës 7.5 deri 8 Ton kemi lejuar minimumin dhe maksimumin e peshës së ngarkesës të pajisjeve, që nënkupton që OE-te konkurrues kanë hapësirë të konsiderueshme të përzgjedhjes rreth peshës së ngarkesës për pajisjet e kërkuara”.

Si ekspert profesional i prokurimit, paraqes mendimin se ky kriter i kufizimit nga 7.5 ton deri në 8 ton dhe nga 5 deri në 6 ton për pajisjen tjetër është kufizues dhe ekzistojnë opinione dhe rekomandime nga KRPP se AK duhet të respektojë nenin 25.6 të Rregullores 001/2022 ku thekson: “25.6 Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë” mbi këtë bazë i rekomandoi Panelit Shqyrtues që pas trajtimit të lëndës të kthimit të lëndës në rivlerësim Autoriteti Kontraktues të respektojë nenin 51 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe kriteret të jenë në përputhje dhe në proporcion me Aktivitetin e Prokurimit. Pra, AK kriterin e përcaktuar në Formularin e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë t’i rregulloi sipas Formularit B54 (Formulari i përmirësimit të gabimit) ku pajisjet e kërkuara t’i rregulloi me Minimum ose Maksimum të peshës (Shembull: Kamion kiper me Vinç – Minimum 5 Ton ose Kamion me Vinç – Maksimum 5 Ton (varësisht prej funksionit), por jo të përcaktonte tavan maksimal nga një minimum i paraqitur me herët), sepse kjo diferencë

prej 0.5ton të kufizuar, e kufizon konkurrencën sepse pajisjet si e tillë është mjaft specifike, ku kjo specifikohet edhe në nenin 19.4 Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara. Në këtë formë AK mund të veproi në kundërshtim me nenin 7, pika 2 ku specifikohet: 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Në këtë rast evidentohet se Ankuesi është pajtuar me raportin e cituar, kurse AK nuk pajtohet duke deklaruar: "Autoriteti kontraktues ka vendosë kushte të dosjes së tenderit të cilat do ti shërbejnë realizimit sa me sukses të këtij projekti. Këto kritere nuk janë as diskriminuese e as favorizuese për asnjë operator ekonomik. Nuk ka kufizime të pa arsyeshme as në DT as në NJK. Pajisjet e kërkuara janë të domosdoshme sipas specifikave të cilat janë vendosë në DT".

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24, paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli Shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë, sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në kontest me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Duhet theksuar fakti ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale të tjera, duke pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj, fakti se në cilat raste dhe për çfarë Paneli mbështetet apo jo në raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të neneve 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues deklaroi se, në kërkesat e dosjes së tenderit, më saktësisht kriterit tek Kërkesa 7, pika 2: Kamion me kran, peshë ngarkesës 5-6 ton = 1 copë dhe pika 4: Kamion kiper me vinç, peshë ngarkesës 7.5-8.0 ton = 1 copë, ky kriter është kufizues. Më tej, Paneli Shqyrtues deklaroi se, duke u bazuar në nenin 25.6 të Rregullores 001/2022, ku theksohet: “25.6 Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë,” Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere diskriminuese në formulimin e dosjes së tenderit, duke kërkuar kritere që mund të ngushtojnë konkurrencën e lirë dhe të interpretohet që AK ka dashur të favorizojë operatorë të caktuar ekonomik.

Paneli gjykon se askund nuk është specifikuar/argumentuar nga AK/ZPP se janë të nevojshme apo të domosdoshme këto pajisje tek Vendimi mbi refuzimin e KRPP, andaj paneli shqyrtues

obligon autoritetin kontraktues të respektohet në plotni neni 7 të LPP-së, duke rritur peshën e ngarkesës nga vlera minimale deri në vlerë maksimale për pajisjet teknike të kërkuar, veç e veç në mënyrë që OE/tenderuesit, të kenë të qarta dhe të mos ketë nevojë për sqarime të mëtutjeshme, duke rritur konkurrencën dhe transparencën lidhur me këtë aktivitet prokurimi në funksion të parimit drejtësisia/mos-diskriminimi, të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për operatorin ekonomik ose operatori ekonomik potencial. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse ashtu siç obligon të gjitha AK neni 51 i LPP-së. Prandaj duke u bazuar në këto fakte analizës së dokumentacionit të prezantuar dhe analizës së mësipërme, pretendimet e palës në ankesë, në këtë pikë janë të qëndrueshme dhe, AK të korrigjoj bëmë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe të zgjas afatin sipas nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues vendosi që pretendimet tjera lidhur me kërkesat teknike dhe profesionale të mbeten ashtu siç janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë nga ana e AK, mirëpo i njëjti duhet të korrigjojë NJK dhe DT në kontekstin e të gjeturave dhe konstatimeve të dhëna si më sipër, të këtij arsytimi sikurse është kërkuar.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen, duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme. Po ashtu, urdhëron që të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën, Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese ka të drejtë të kërkojë ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - Rinesa SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: